

Pardje isha ne Gjirokastrë, për një ndalesë tjetër në zbatim të planit të pastrimit kombëtar. Teksa punonin me stafin e bashkisë u përpoqa t'i shpjegoja një djali 10-vjeçar pse mbeturinat duheshin hedhur vetëm në vendin e caktuar dhe se si të gjithë bashkë mund ta mbanim sokakun të pastër. Përgjigjja e tij si plumb ishte: "T'i pastrojë bashkia, se atë punë ka". Episodi i dytë Dje, këtu te Bregu i Lumit, në kufi të dy bashkive, asaj të Tiranës dhe asaj të Kamzës, prej disa ditësh po punohej me stafet e Bashkisë së Tiranës, që është një tjetër stacion i pastrimit kombëtar, na u bashkuan edhe punonjësit e Bashkisë së Kamzës, të Ministrisë së Mjedisit dhe Forcat e Armatosura. Bashkë me kryetarin e Bashkisë së Tiranës dhe kryetarin e Bashkisë së Kamzës punuam dhe pastruam dje një vatër të tmerrshme plehrash në një fushë te Bregu i Lumit, e cila jo vetëm u çlirua nga mbetjet urbane të depozituara ilegalisht, por edhe do të mbillet me pemë e do të rehabilitohet. Nuk po e tregoj për të thënë se çfarë bëme dje, por po e tregoj për të thënë se çfarë më dhëmbi më shumë. Disa nga banorët na bënë sehir, disa na qesëndisën, madje disa edhe na akuzuan pse po pastronim mbetjet e tyre, ndonëse të ndërgjegjshëm që prej dekadash tashmë jetonin në hapësira të zaptuara pa kut e pa hesap teksa bashkia tashmë po punon për t'i urbanizuar, për t'i rregulluar dhe ku duhet të marrë fund përdhunimi i mjedisit.

Në fakt, jua tregova këto dy episode për t'ju treguar se lufta për pastrimin e territorit nuk është thjesht luftë me mbetjet dhe pisllekun, është luftë me mendjet, është përplasje me mentalitetet, është betejë për edukim! Kur themi pastrim, nuk mjafton të themi që pastruam dhjetëra apo mijëra kilometra katrorë territor nga mbetjet pa pastruar dhjetë centimetra që kemi brenda kokës sonë nga mentaliteti se çka është publike nuk është imja, çka është për t'u pastruar nuk është detyra ime, edukim, që në fakt rrallëherë e kemi marrë seriozisht. Sot jemi vonë, por jo në pamundësi për të këmbëngulur te ndryshimi dhe te kthesa. Kam dëgjuar shpesh këto ditë gjëra të tilla, si: kot e keni, ju pastrojeni sa të doni, por njerëzit prapë do t'i hedhin aty! Po si more do t'i hedhin aty, po cilët janë njerëzit?! Ne jemi njerëzit tanë, ata me të cilët ndajmë oborrin, shtëpinë, fshatin apo rrugën! Ju të gjithë që jetoni dhe përfaqësoni. Ne të gjithë që përfaqësojmë komunitete të ndryshme, shkojmë në takime dhe flasim me ta, rrallëherë flasim për mjedisin dhe për mënyrën sesi duhet ta mbrojmë atë, ngaqë nuk e konsiderojmë hall, por është hall dhe hall shumë i madh.

Erdhi dita ta konsiderojmë të tillë, prandaj të tillë e kemi konsideruar edhe në buxhetin e vitit 2022. Kështu që, krahas punës në terren, të nisur tashmë nga Veriu në Jug, për zbatimin e planit të pastrimit kombëtar, buxheti i vitit që vjen parashikon ndërhyrje të posaçme për të mbështetur financiarisht këtë problem serioz, i cili lidhet drejtpërsëdrejti me mbështetjen që u jepet bashkive që ndërtojnë sistemin e menaxhimit të integruar të mbetjeve, sipas standardeve të vendosura nga ligji dhe Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. 500 milionë lekë të rinj do të vihen në dispozicion të tyre këtë vit. Turizmi, që është një nga sektorët në rritje të ekonomisë sonë dhe që ia doli ta rimarrë veten pas vitit fatkeq 2020, përtej pritshmërive tona, sa është i domosdoshëm për të gjitha bizneset turistike, aq është edhe një kërcënim për mjedisin nëse nuk menaxhohet mirë dhe nëse nuk marrim masat në kohë.

Që ta kuptojmë pak për çfarë po flasim, në janar-shtator të vitit 2019 kishim 5 462 000 turistë të huaj; në janar-shtator të vitit 2020 kishim 2 122 200 turistë të huaj; në janar-shtator të vitit 2021 kishim 4 878 404 turistë të huaj; në tetor të këtij viti kishim 5 177 116 turistë të huaj. Vetëm në javën e parë të nëntorit e kanë vizituar Shqipërinë 60 804 turistë të huaj. Edhe sot që flasim turizmi vazhdon, madje

në Gjirokastrë, në fundjavë, nuk ka më vende të lira në hotele. Mos u kompleksoni sa herë përmend Gjirokastrën, sepse është modeli që duam dhe pse të mos e bëjmë kudo. Tani problemi më i madh janë bashkitë e bregdetit, ku në disa prej tyre edhe 10-fishohet popullsia gjatë sezonit veror. Për këtë qeveria ka vlerësuar të ndërhyjë me mjete shtesë përmes AKB-së në bashkitë më të populluara gjatë sezonit veror, pra për tre muajt e verës, jo vetëm për të rritur cilësinë e shërbimit, por sidomos për të mbrojtur mjedisin, shëndetin e banorëve dhe të turistëve që popullojnë plazhet në atë sezon.

Tri projekte rikualifikimi do të zbatohen në zonat e mbrojtura, që do të shërbejnë jo vetëm për rritjen e cilësisë së shërbimit dhe mbrojtjen e tyre, por edhe për promovimin e tyre për qëllime turistike, konkretisht: do të përfundojë brenda vitit 2022 investimi i rikualifikimit të plotë të shërbimeve dhe rrugëve në zonën e Syrit të Kaltër, në Sarandë, që gjithmonë ka qenë problem; do të ndërtohet një qendër e re multifunkionale për zonën e re të mbrojtur të lumit Vjosa me vlerë 50 milionë lekë të rinj, që do të jetë në shërbim të vizitorëve si një urë komunikimi, midis komunitetit që jeton atje prej shekujsh, por edhe të turistëve gjithmonë e më të shpeshtë në këtë territor. Të shtata bashkitë, që kanë rreth 60 mijë banorë, kanë nevojë për modelet e zhvillimit të qëndrueshëm. Është e vetmja mënyrë që zona përreth Vjosës të mbrohet dhe të zhvillohet në të njëjtën kohë. Një tjetër investim i rëndësishëm, do të jetë Eco Park Ulza, që do të ofrojë një tjetër projekt në zonën e mbrojtur rreth liqenit të Ulzës, por edhe për të bërë promovimin dhe zhvillimin e turizmit në atë zonë. Një tjetër projekt në fushën e turizmit do të jetë hartimi i projektzbatimit të rikualifikimit të pikave hyrëse dhe dalje për vizitorët në Qafë Thanë, Kapshticë, Kakavijë, Rinas, Muriqan, Hani i Hotit, Morinë, për të mirëpritur vizitorët, por edhe për t'i përcjellë ata me ndjesinë e mirë dhe kujtimin e një Shqipërie turistike mikpritëse. Pa diskutim që Ministria e Turizmit do të vijojë të jetë, gjithashtu, bashkëkontributore me Ministrinë e Bujqësisë në pagesat e garancisë sovrane për të lehtësuar kreditë e buta në agroturizëm, sepse konsiderojmë që turizmi nuk mund të jetë vetëm turizmi i detit dhe i diellit, por turizmi 12-mujor, ekoturizmi dhe agroturizmi bashkë me turizmin natyror luajnë një rol shumë të rëndësishëm.

Tani do të ndalem te mbetjet. Ministria e Turizmit prej katër vjetësh ka avancuar me projekte rehabilitimi të venddepozitimeve ilegale që në Shqipëri, pas studimit të vitit 2018, janë 190 të trashëguara, si çibanë të vjetër e të rinj në trupin e republikës. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të vijojë me procesin e mbylljes dhe rehabilitimit. Edhe sot që flasim vazhdohet të punohet në terren, por ky nuk është një aksion, por një plan kombëtar që do të vazhdojë edhe pas datës 1 janar dhe ka dy qëllime: së pari, pastrimin e territorit, së dyti, edukimin e mendjeve tona si bashkëkontributorë në ndotje dhe si bashkëkontributorë në pastrim për të reduktuar volumin e mbetjeve. Për ta bërë këtë është shumë e rëndësishme të bëjmë një kthesë të madhe për të kuptuar se ne që prodhojmë e vetmja mënyrë për ta ulur dhe për të reduktuar volumin e mbetjeve është riciklimi i mbetjeve në burim, letrës, plastikës dhe mbetjeve organike për kompostim.

Le ta nisim nga kjo sallë, zonja Kryetare, të nderuar kolegë, nga institucioni ynë me i lartë ligjvënës, të mos i hedhim mbetjet e letrave, por t'i grumbullojmë. Përdorim pa fund sasi letrash në këtë institucion, le të marrim një iniciativë t'i grumbullojmë dhe të furnizojmë me to ekonomitë ricikluese. Kuvendi dhe institucione të tjera publike konsumojmë tonelata me letër që i hedhin në kosha, ndërkohë që ka një ekonomi riciklimi të letrës në Shqipëri që po fiket, sepse ne po sillemi shumë keq. Prandaj, siç thoshte Nënë Tereza që e djeshmja iku, e nesërmja nuk ka ardhur, ne kemi vetëm të tashmen, le ta fillojmë këtë aksion. Faleminderit!